



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori k. Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 shkurt 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku
Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe ku Kërkohet
Informacion**

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Zyrës Administrative

Administratores

Shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së

Viktimave

T'i dorëzohet:

Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim mbi zbatimin e nenit 22(9) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), ku përcaktohen hapat e mëtejshëm proceduralë në këtë çështje dhe kërkohet informacion.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 maj 2021, Trupi Gjykues lëshoi “Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)” (Vendimi), në të cilin urdhëroi Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) që të dorëzonte, deri më 4 qershor 2021, një listë me tre ekspertë përkatës të disponueshëm brenda një kohe të shkurtër për përgatitjen e aktekspertizës së përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit në lidhje me aspektin se a ofrojnë gjykatat shtetërore në Kosovë mundësi reale që viktimat në këtë çështje të kërkojnë zhdëmtim dhe, nëse do të miratohej zhdëmtim me vendime të lëshuara nga gjykatat shtetërore në Kosovë, a do të zbatoheshin vendime të tilla.¹ Trupi Gjykues gjithashtu urdhëroi Mbrojtjen e Salih Mustafës (përkatësisht Mbrojtja dhe i akuzuari) dhe mbrojtësen e viktimave që të dorëzonin vërejtje, nëse kishin, brenda dhjetë ditësh nga njoftimi për parashtrim nga ZPV-ja.²

2. Më 4 qershor 2021, Administratorja dorëzoi “Parashtrimin e Zyrës Administrative në përputhje me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)”, në të cilin ZPV-ja identifikoi tre ekspertë të cilët “plotësojnë mjaftueshëmrisht kushtet”, e përcaktuara në Vendim.³

¹ KSC-BC-2020-05, F00124, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 20 maj 2021, publik, para. 24(a). Protokollimi u njoftua më 21 maj 2021.

² Vendimi, para. 24(b).

³ KSC-BC-2020-05, F00132, Administratorja, *Parashtrim i Zyrës Administrative në përputhje me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (Parashtrimi i Parë i ZPV-së), 4 qershor 2021, publik, me Shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*.

3. Më 14 qershor 2021, mbrojtësja e viktimave dorëzoi “Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)”, ku përfshiheshin një numër pyetjesh për ekspertët që do të caktoheshin.⁴ Mbrojtja nuk dorëzoi parashtrim.
4. Më 25 qershor 2021, Trupi Gjykses lëshoi “Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)”, duke e urdhëruar ZPV-në që të dorëzonte, deri më 21 korrik 2021, listën e ekspertëve të tjerë përkatës nga jashtë Kosovës të disponueshëm brenda një kohe të shkurtër për përgatitjen e aktekspertizës së përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të Vendimit.⁵ Trupi Gjykses gjithashtu e urdhëroi Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave që të dorëzonin deri më 20 gusht 2021 parashtrime, nëse do të kishin, në lidhje me parashtrimet e ZPV-së.⁶
5. Më 12 korrik 2021, Trupi Gjykses lëshoi “Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit” (Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave).⁷
6. Më 21 korrik 2021, Administratorja dorëzoi “Parashtrimin e Zyrës Administrative në përputhje me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)”, në të cilin ZPV-ja identifikonte tre ekspertë të tjerë përkatës për shqyrtim nga Trupi Gjykses.⁸

⁴ KSC-BC-2020-05, F00134, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 14 qershor 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00140, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (Vendimi i Dytë), 25 qershor 2021, konfidencial, para. 9-10, 12(a). Një version i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00140/RED.

⁶ Vendimi i Dytë, para. 12(b).

⁷ KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit*, 12 korrik 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00157, Administratorja, *Parashtrim i Zyrës Administrative në përputhje me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (Parashtrimi i Dytë i ZPV-së), 21 korrik 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-4, konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 10 shtator 2021, F00157/RED.

7. Më 19 gusht 2021, mbrojtësja e viktimave dorëzoi “Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave në Lidhje me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)”,⁹ përfshirë listën e pyetjeve për shqyrtim nga ekspertët.¹⁰ Mbrojtja nuk dorëzoi parashtrim.

8. Më 3 shtator 2021, Trupi Gjykses lëshoi “Vendimin e Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve” (Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve), ku caktoi tre ekspertë në çështjen aktuale (ekspertët e caktuar), duke i udhëzuar të raportonin në lidhje me temat e identifikuara nga Trupi Gjykses deri më 22 nëntor 2021, dhe duke udhëzuar Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave që të dorëzonin parashtrime në lidhje me aktekspertizat, nëse dëshironin, brenda dy javësh nga njoftimi i tyre.¹¹

9. Më 15 shtator 2021, në deklaratën hyrëse, mbrojtësja e viktimave, midis të tjerash, i kërkoi Trupit Gjykses që të mos i referojë viktimat që përfaqëson për padi civile në gjykatat e Kosovës.¹²

10. Më 20 shtator 2021, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e mbrojtëses së viktimave për rishqyrtimin¹³ e Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve.¹⁴

11. Më 18 tetor 2021, mbrojtësja e viktimave dorëzoi “Parashtrimin e Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet” (Parashtrimet e Para të Viktimave), ku përsëriste kërkesën e saj që Trupi Gjykses të mos i referojë viktimat për padi civile në gjykatat e

⁹ KSC-BC-2020-05, F00166, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave lidhur me Vendimin e Dytë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (Parashtrimi i Dytë i Viktimave), 19 gusht 2021, publik, me Shtojcën 1, publike.

¹⁰ Shtojca 1 e Parashtrimit të Dytë të Viktimave.

¹¹ KSC-BC-2020-05, F00184, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 3 shtator 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00184/RED.

¹² KSC-BC-2020-05, Transkripti i Seancës, 15 shtator 2021 (Transkripti i 15 shtatorit 2021), publik, f. 345, rreshti 5 deri te f. 373, rreshti 19.

¹³ KSC-BC-2020-05, F00190, Mbrojtësja e Viktimave, *Mocion i Mbrojtëses së Viktimave për Rishqyrtimin e Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* (Kërkesa për Rishqyrtim), 7 shtator 2021, publik. Mbrojtja nuk iu përgjigj Kërkesës për Rishqyrtim.

¹⁴ KSC-BC-2020-05, F00209, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Rishqyrtimin e Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)*, 20 shtator 2021, publik.

Kosovës, por ta përfshijë vendimin për dëme, humbje dhe lëndime në aktgjykimin e tij.¹⁵

12. Më 19 nëntor 2021, me kërkesë të ZPV-së¹⁶ dhe mbrojtëses së viktimave,¹⁷ Trupi Gjykses e zgjati afatin për parashtrimin e aktekspertizës (aktekspertizave) deri më 17 dhjetor 2021 dhe afatin për parashtrime nga Mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave në lidhje me aktekspertizën (aktekspertizat) deri më 21 janar 2022.¹⁸

13. Më 13 dhjetor 2021, duke pasur parasysh fazën e avancuar të paraqitjes së provave prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), Trupi Gjykses i informoi palët dhe mbrojtësen e viktimave për kalendarin paraprak të hapave të ardhshëm proceduralë në këtë çështje, me të vetmin qëllim që t'i njoftonte për hapat përgatitorë që do të merren kur të përfundojë paraqitja e provave prej ZPS-së.¹⁹

¹⁵ KSC-BC-2020-05, F00239, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave mbi Zhdëmtimet*, 18 tetor 2021, publik.

¹⁶ KSC-BC-2020-05, F00252, Zyra Administrative, *Kërkesë për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave)*, 15 nëntor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më 17 nëntor 2021, F00252/RED.

¹⁷ KSC-BC-2020-05, F00259, Mbrojtësja e Viktimave, *Përgjigja e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave)*, të datës 15 nëntor 2021 (F00252), 18 nëntor 2021, publik.

¹⁸ KSC-BC-2020-05, F00260, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesat për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave dhe Parashtrime në lidhje me To*, 19 nëntor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00260/RED.

¹⁹ KSC-BC-2020-05, Transkripti i Seancës, 13 dhjetor 2021, publik, f. 1919, rreshti 2 deri në f. 1920, rreshti 16.

14. Më 17 dhjetor 2021, Zyra Administrative i dërgoi²⁰ Trupit Gjykses aktekspertizat përkatëse të ekspertëve të caktuar (përkatësisht aktekspertiza e parë,²¹ aktekspertiza e dytë,²² dhe aktekspertiza e tretë,²³ dhe së bashku “aktekspertizat”).

15. Më 20 janar 2022, me kërkesë të mbrojtëses së viktimave,²⁴ Trupi Gjykses e zgjati afatin për parashtrime nga Mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave në lidhje me aktekspertizat deri më 25 janar 2022.²⁵

16. Më 21 janar 2022, Trupi Gjykses lëshoi “Vendimin e Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit” (Vendimi i Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit), duke urdhëruar, midis tjerash, mbrojtësen e viktimave të paraqesë deri më 11 shkurt 2022 listën e propozuar të dëshmitarëve (ekspertë) që do të thirren nga Trupi Gjykses dhe material tjetër të rëndësishëm që nuk është provë gojore, parashtrimin e të cilit ajo dëshiron që ta urdhërojë Trupi Gjykses, që ka lidhje me zbardhjen e së vërtetës.²⁶

17. Më 24 janar 2022, mbrojtësja e viktimave, midis tjerash, kërkoi nga Trupi Gjykses të caktojë një ekspert që të vlerësojë nga ana mjekësore dëmin fizik dhe psikologjik të

²⁰ KSC-BC-2020-05, F00287, Administratorja, *Dërgimi i Aktekspertizave me Katër Shtojca Konfidenciale dhe dy Shtojca Publike*, 17 dhjetor 2021, publik, me Shtojcat 1, 3, 5-6, konfidenciale, dhe Shtojcat 2-4, publike.

²¹ KSC-BC-2020-05, F00287/A01, Administratorja, *Aktekspertizë e Parashtruar nga* [REDAKTUAR], 17 dhjetor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00287/A02.

²² KSC-BC-2020-05, F00287/A03, Administratorja, *Aktekspertizë e Parashtruar nga* [REDAKTUAR], 17 dhjetor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00287/A04.

²³ KSC-BC-2020-05, F00287/A06, Administratorja, *Aktekspertizë e Parashtruar nga* [REDAKTUAR], 17 dhjetor 2021, konfidencial. Përkthimi në anglishte i aktekspertizës u protokollua më 14 janar 2022, në formë konfidenciale (F00287/A06/eng) dhe në formë publike (F00287/A06/eng/RED).

²⁴ KSC-BC-2020-05, F00291, Mbrojtësja e Viktimave, *Mocion i Mbrojtëses së Viktimave për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Parashtrimeve të saj në lidhje me Aktekspertizat*, 20 janar 2022, publik.

²⁵ KSC-BC-2020-05, F00292, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Mocionin për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Parashtrimeve në lidhje me Aktekspertizat*, 20 janar 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00292/RED.

²⁶ KSC-BC-2020-05, F00296, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 21 janar 2022, publik, para. 21(g).

pësuar nga tri prej viktimave të drejtpërdrejta në çështjen aktuale (Parashtrimet e 24 Janarit të Viktimave).²⁷

18. Gjithashtu, më 24 janar 2022, mbrojtësja e viktimave dhe Mbrojtja protokolluan parashtrimet përkatëse në lidhje me aktekspertizat (përkatësisht, Parashtrimet e Dytë të Viktimave²⁸ dhe Parashtrimet e Mbrojtjes²⁹).

II. PARASHTRIMET

19. Në deklaratën hyrëse dhe Parashtrimet e Para të Viktimave, mbrojtësja e viktimave parashtron se praktika e gjykatave shtetërore dhe ndërkombëtare deri më sot si dhe konstatimet e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim tregojnë se referimi i viktimave te gjykatat shtetërore për të kërkuar kompensim – në rastet kur kjo është ligjrisht e mundshme – nuk është opsion efektiv, për shkak se faktorë si legjislacioni vendor, korniza institucionale, praktika politike, dhe burimet e disponueshme përcaktojnë nëse viktimat kanë qasje në mjete ligjore, si rezultat i të cilave disa viktimat mund të marrin kompensim, ndërsa të tjerë jo.³⁰ Për këtë arsye, tribunalët ndërkombëtarë, përfshirë Dhomat e Specializuara (DHS), duhet të shfrytëzojnë të gjitha kompetencat e tyre për zbatimin e të drejtave të viktimave për kompensim, e jo t'i referojnë ato për padi civile në gjykatat shtetërore.³¹ Mbrojtësja e viktimave gjithashtu parashtron se referimi i viktimave për padi civile në gjykatat në Kosovë

²⁷ KSC-BC-2020-05, F00297, Mbrojtësja e Viktimave, Kërkesë e Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Vendimin e Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit të datës 21 janar 2022, 24 janar 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00297/RED.

²⁸ KSC-BC-2020-05, F00298, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtëses së Viktimave mbi Aktekspertizat në lidhje me Referimin e Proceseve për Zhdëmtim në Gjykatat Shtetërore në Kosovë*, 24 janar 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00298/RED.

²⁹ KSC-BC-2020-05, F00299, Mbrojtja, *Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Aktekspertizat e Ekspertëve të Caktuar*, 24 janar 2022, publik.

³⁰ Transkript i 15 shtator 2021, f. 359, rreshti 11 deri në f. 363, rreshti 22; Parashtrimet e Para të Viktimave, para. 14-23. *Shih gjithashtu* Transkript i 15 shtator 2021, f. 364, rreshtat 14-17.

³¹ Transkript i 15 shtator 2021, f. 364, rreshti 10 to f. 365, rreshti 1, f. 368, rreshtat 15-19; Parashtrimet e Para të Viktimave, para. 25.

mund t'i shkelë të drejtat e tyre, duke vënë në dukje, midis tjerash, se: (i) zhdëmtimi i viktimave aktualisht është fushë e panjohur në gjykimet për krime lufte në Kosovë, meqenëse aktualisht është e paqartë nëse ligji për kompensimin e viktimave të krimit në Kosovë mbulon viktimat e krimeve të luftës;³² (ii) ndryshe nga proceset penale, proceset civile nuk parashohin asnjë mekanizëm ligjor për mbrojtjen e identitetit të viktimave, ku si pasojë viktimat nuk mundën dhe nuk do të kërkojnë kompensim në procese të tilla për shkak të rrezikut se do të zbulohen;³³ dhe (iii) mekanizmat ekzistues për kompensim dhe dëmshpërblim në vendet e ish-Jugosllavisë nuk mbulojnë çdokënd që ka nevojë për mjet ligjor.³⁴ Rrjedhimisht, mbrojtësja e viktimave kërkon nga Trupi Gjykoës që të shqyrtojë kërkesat e viktimave pjesëmarrëse në tërësi dhe të caktojë shkallën dhe masën e çfarëdo dëmi dhe lëndimi të pësuar në pajtim me nenin 22(7) të Ligjit.³⁵

20. Në aktekspertizën e parë, eksperti (eksperti i parë) parashtron se, nëse viktimat e krimit brenda juridiksionit të DHS-së do të kërkojnë kompensim në gjykatat civile në Kosovë, mund të përballen me vështirësi ligjore dhe praktike.³⁶ Konkretisht, eksperti i parë parashtron, midis të tjerash se: (i) ekziston një shkallë korrupsioni dhe ndërhyrjeje brenda sistemit juridik në Kosovë;³⁷ (ii) kohëzgjatja e çështjeve civile në Kosovë është shqetësuese;³⁸ (iii) ndërsa krimet e luftës nuk kanë afat të parashkrimit, megjithatë afatet e parashkrimit mund të vlejnjë për paditë civile të ngritura nga viktimat e krimeve të tilla;³⁹ (iv) procedurat e anonimitetit nuk janë zbatuar në çështje civile, meqenëse Ligji Nr. 04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (Ligji për Mbrojtjen

³² Transkript i 15 shtator 2021, f. 365, rreshtat 4-18; Parashtrimet e Para të Viktimave, para. 27.

³³ Transkript i 15 shtator 2021, f. 365, rreshtat 19-24; Parashtrimet e Para të Viktimave, para. 28.

³⁴ Transkript i 15 shtator 2021, f. 365, rreshti 25 to f. 366, rreshti 6; Parashtrimet e Para të Viktimave, para. 30.

³⁵ Transkript i 15 shtator 2021, f. 366, rreshtat 7-10, f. 367, rreshtat 5-12, f. 368, rreshtat 20-22, f. 369, rreshtat 5-8, f. 373, rreshtat 2-3; Parashtrimet e Para të Viktimave, para. 31, 37.

³⁶ Aktekspertiza e Parë, f. 44-45.

³⁷ Aktekspertiza e Parë, f. 3-12.

³⁸ Aktekspertiza e Parë, f. 9, 13-14, 31-34.

³⁹ Aktekspertiza e Parë, f. 30-31.

e Dëshmitarëve) është kufizuar brenda çështjeve penale dhe si rrjedhojë nuk vlen për çështjet civile, dhe aktualisht nuk ekziston baza ligjore për mbrojtjen e viktimave që kërkojnë kompensim pas aktgjykimeve penale;⁴⁰ (v) Ligji Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin (Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimin) nuk vlen për viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së dhe asnjë viktimë e krimeve të luftës nuk ka përfituar kompensim nga fondi i krijuar sipas ligjit të lartpërmendur;⁴¹ (vi) Kosova ka lidhur vetëm dy marrëveshje bilaterale në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje civile, të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi, dhe nuk ka aderuar në Konventat e Konferencës së Hagës që rregullon çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje civile;⁴² dhe (vii) zbatimi i dëmshpërblimit të shpallur nga gjykatat e Kosovës kundrejt pasurive jashtë territorit të Kosovës do të kërkonte që palët e interesuara të kërkojnë njohjen dhe zbatimin e dëmshpërblimeve të Kosovës nga gjykatat e shtetit përkatës sipas ligjeve në fuqi të atij shteti.⁴³ Sa i përket ndihmës juridike, eksperti i parë rendit disa subjekte që do të mund t'i jepnin mbështetje viktimave të përmendura në vendimet e DHS-së.⁴⁴

21. Në aktekspertizën e dytë, eksperti (eksperti i dytë) parashtron se është vështirë të matet niveli i korrupsionit ndër punonjësit e gjykatave në Kosovë dhe në të vërtetë mund të jetë më i ulët se perceptimi i publikut të gjerë; sidoqoftë, faktorë si vetë ekzistenca e retorikës për korrupsion dhe mungesa e masave të llogaridhënies për një kohë të gjatë mund të nxisin praktika të tilla.⁴⁵ Eksperti i dytë më tej parashtron se Trupi Gjykses mund të marrë parasysh një numër faktorësh kur të vendosë në lidhje me forumin e përshtatshëm për lëshimin e një urdhri të mundshëm për zhdëmtim, përfshirë, midis të tjerash, se: (i) legjislacioni në Kosovë nuk parasheh masa për padi

⁴⁰ Aktekspertiza e Parë, f. 21-24, 27.

⁴¹ Aktekspertiza e Parë, f. 14-16, 19, 24-25, 27-28, 46.

⁴² Aktekspertiza e Parë, f. 37-39.

⁴³ Aktekspertiza e Parë, f. 36-37.

⁴⁴ Aktekspertiza e Parë, f. 17-19.

⁴⁵ Aktekspertiza e Dytë, para. 18-30.

civile anonime, për rrjedhojë, nëse viktimat nuk duan të bëjnë padi civile në Kosovë duke e zbuluar identitetin e vet, çdo diskutim në lidhje me sistemin juridik në Kosovë është praktikisht i padobishëm;⁴⁶ (ii) korniza aktuale ligjore në Kosovë nuk parasheh mbrojtjen e dëshmitarëve në çështje civile dhe pajisjet teknike të nevojshme për zbatimin e masave të tilla, në çdo rast, mund të mos jenë gjithmonë të disponueshme;⁴⁷ (iii) korniza ligjore në fuqi u jep gjykatave shtetërore kompetencë diskrecionale në përcaktimin e afatit e zbatueshëm të parashkrimit bazuar në rrethanat individuale të çështjes dhe, ndërsa thuhet nuk ka të ngjarë që gjykatat të ndalojnë procese civile si rezultat i ndonjë aktgjykimi nga DHS-ja, mund të nevojiten diskutime të drejtpërdrejta midis autoriteteve gjyqësore kosovare dhe DHS-së për të vendosur në lidhje me kornizën ligjore të zbatueshme dhe për të garantuar njëtrajshmëri;⁴⁸ (iv) Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit nuk vlen për viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së;⁴⁹ dhe (v) viktimat mund të ndikohen negativisht nga kohëzgjatja e proceseve civile në Kosovë.⁵⁰ Në fund, eksperti i dytë gjithashtu përmend një numër subjektësh që do të mund t'u jepnin mbështetje viktimave sa i përket ndihmës juridike.⁵¹

22. Në aktekspertizën e tretë, eksperti (eksperti i tretë) parashtron se praktika gjyqësore ekzistuese në Kosovë dhe qëndrimi ndaj DHS-së nuk sugjerojnë se autoritetet gjyqësore ose administrative do të kenë vullnetin që të kompensojnë viktimat të cilave mund t'u miratohet një status i tillë në aktgjykimet e lëshuara nga DHS-ja.⁵² Konkretisht, eksperti i tretë midis të tjerash vë në dukje: (i) punën e dobët të autoriteteve gjyqësore lidhur me ushtrimin e të drejtës për kompensim në çështjet e

⁴⁶ Aktekspertiza e Dytë, para. 39-40.

⁴⁷ Aktekspertiza e Dytë, para. 42-43. *Shih gjithashtu* para. 60.

⁴⁸ Aktekspertiza e Dytë, para. 46.

⁴⁹ Aktekspertiza e Dytë, para. 47, 67.

⁵⁰ Aktekspertiza e Dytë, para. 48-49.

⁵¹ Aktekspertiza e Dytë, para. 50.

⁵² Aktekspertiza e Tretë, f. 20-21.

krimeve të luftës, edhe pse ekzistojnë ligje të zhvilluara mirë sa i përket kësaj çështjeje;⁵³ (ii) çështjet e prapambetura dhe vonesat që mbizotërojnë në fushën e të drejtës civile;⁵⁴ dhe (iii) faktin që, ndërsa është e vështirë të vlerësohet shpeshtësia e tyre në realitet, korrupsioni në institucionet gjyqësore dhe ndërhyrja politike në punën e tyre, duke përfshirë të ashtuquajturat çështje të profilit të lartë, diskutohen gjerësisht nga publiku në Kosovë.⁵⁵ Eksperti i tretë parashtron se: (i) ndërsa ndihma juridike do të ishte e disponueshme në gjykatat në Kosovë, fondet ekzistuese nuk ofrojnë mjete të mjaftueshme për të garantuar se ndihma juridike do të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme;⁵⁶ dhe (ii) nuk do të ishte i mundshëm zbatimi i dëmshpërblimit të miratuar nga gjykatat e Kosovës kundrejt pasurive që gjenden në territorin e një vendi që nuk ka marrëveshje për bashkëpunim gjyqësor apo lidhje diplomatike me Kosovën.⁵⁷ Sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e viktimave, eksperti i tretë pohon se: (i) korniza ligjore aktuale në Kosovë nuk lejon ngritjen dhe/ose zbatimin e padive civile anonime;⁵⁸ (ii) Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve rregullon vetëm procedurën për mbrojtjen e dëshmitarëve në çështje penale;⁵⁹ dhe (iii) ndërsa dispozitat ligjore përkatëse sugjerojnë se personi që ngre padi civile mund të kërkojë zbatimin e masave të caktuara mbrojtëse, bazuar në arsye të vlefshme, praktika gjyqësore deri më sot dhe hulumtimi i kryer nga eksperti i tretë tregojnë se kjo nuk ka ndodhur asnjëherë në praktikë.⁶⁰ Sa i përket përfitimit të kompensimit nga një person i dënuar që është i varfër, eksperti i tretë parashtron se: (i) viktimat e krimeve brenda juridiksionit të DHS-së mund të përfitojnë dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur në paragrafin 15 të Vendimit të Tretë mbi

⁵³ Aktekspertiza e Tretë, f. 20, 23, 49-50. *Shih gjithashtu* f. 8-20.

⁵⁴ Aktekspertiza e Tretë, f. 21, 24, 30-33, 41-42, 52-53.

⁵⁵ Aktekspertiza e Tretë, f. 24, 30, 36. *Shih gjithashtu* f. 30-35, 37-40.

⁵⁶ Aktekspertiza e Tretë, f. 23-24. *Shih gjithashtu* f. 42-45.

⁵⁷ Aktekspertiza e Tretë, f. 57.

⁵⁸ Aktekspertiza e Tretë, f. 21, 25, 29, 47-48.

⁵⁹ Aktekspertiza e Tretë, f. 13, 47.

⁶⁰ Aktekspertiza e Tretë, f. 25, 47.

Caktimin e Ekspertëve apo nga programe të tjera për kompensim;⁶¹ sidoqoftë nuk ka informacion që tregon se viktimat e krimeve të luftës e kanë kontaktuar ndonjëherë fondin e lartpërmendur;⁶² dhe (ii) Ligji për Kompensimin e Viktimave saktëson veprat penale për të cilat viktimat mund të kërkojnë kompensim dhe ai nuk përfshin konkretisht krimet e luftës; sidoqoftë, neni 6(2) i këtij ligji i jep komisionit përkatës njëfarë fleksibiliteti në lidhje me pretendimet e viktimave në lidhje me vepra të tjera të rënda penale.⁶³

23. Në Parashtrimet e Dyta të Viktimave, mbrojtësja e viktimave parashtron se konstatimet e ekspertëve të caktuar sqarojnë në përgjithësi se gjykatat shtetërore në Kosovë nuk ofrojnë mundësi reale për ngritjen e padive për të kërkuar zhdëmtim prej viktimave të krimeve të pretenduara në çështjen aktuale dhe zbatimin e aktgjykimeve të tilla.⁶⁴ Në këtë aspekt, mbrojtësja e viktimave vë në dukje se: (i) aktekspertizat bëjnë të qartë se sistemi gjyqësor në Kosovë është i ngarkuar tej mase; administrimi i drejtësisë është i ngadaltë dhe vuan nga numri në rritje i çështjeve të prapambetura⁶⁵ dhe se, rrjedhimisht, referimi i kërkesave të viktimave për zhdëmtim te gjykatat shtetërore, sipas të gjitha gjasave do t'i shkelte të drejtat e tyre në bazë të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore (KEDNJ), që çështja e tyre të shqyrtohet brenda një kohe të arsyeshme;⁶⁶ (ii) ndihma juridike e disponueshme në Kosovë është në një shkallë të kufizuar dhe rrezikon që viktimat të mbeten pa ndihmë të mirëfilltë;⁶⁷ (iii) aktekspertizat thuajse nuk lënë dyshim se anonimiteti dhe/ose masat e tjera mbrojtëse nuk janë të disponueshme për padi civile, që do të thotë se nuk mund të garantohet siguria dhe mirëqenia e

⁶¹ Aktekspertiza e Tretë, f. 28, 50.

⁶² Aktekspertiza e Tretë, f. 19, 23, 50.

⁶³ Aktekspertiza e Tretë, f. 14-15, 29, 50.

⁶⁴ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 18, 42.

⁶⁵ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 20-23, 41.

⁶⁶ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 24-26, 41.

⁶⁷ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 28.

viktimave në çështje civile para gjykatave të Kosovës;⁶⁸ (iv) të gjitha aktekspertizat sugjerojnë paqartësi sa i përket afatit të parashkrimit që mund të ndalojë paditë private nga viktimat në gjykatat shtetërore të Kosovës;⁶⁹ (v) pas shpalljes së dëmshpërblimit nga gjykatat shtetërore të Kosovës, viktimat do të kishin në dispozicion opsione të kufizuara të zbatimit në nivel ndërkombëtar dhe opsionet ekzistuese do t'i vështirësonin dhe do t'i zgjasnin procedurat edhe më tej;⁷⁰ dhe (vi) ekspertët e caktuar pajtohen se brenda institucioneve gjyqësore ekziston njëfarë shkalle e ndërhyrjes politike dhe korrupsionit.⁷¹ Rrjedhimisht, mbrojtësja e viktimave kërkon që procesi për zhdëmtim që do të rezultonte nga Urdhri për Zhdëmtim në pajtim me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit, të kryhet para Trupit Gjykues.⁷² Si alternativë, nëse Trupi Gjykues vazhdon ta konsiderojë referimin, mbrojtësja e viktimave kërkon që t'u bëjë pyetje ekspertëve të caktuar në pajtim me rregullën 149(2)(c) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).⁷³

24. Mbrojtja pohon se nuk ka parashtrime në lidhje me aktekspertizat, megjithatë dëshiron t'i marrë në pyetje ekspertët e caktuar (Kërkesa e Mbrojtjes).⁷⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

25. Trupi Gjykues vë në dukje nenet 22(3) dhe (7)-(9), 23, 40(2), 44(6), dhe 53(1) të Ligjit dhe rregullat 80, 116(1), dhe 167-168 të Rregullores.

26. Trupi Gjykues më tej vëren se neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kushtetuta) thotë se: "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të

⁶⁸ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 29-35, 41.

⁶⁹ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 36.

⁷⁰ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 38.

⁷¹ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 39-41.

⁷² Parashtrimet e Dyta të Viktimave f. 12.

⁷³ Parashtrimet e Dyta të Viktimave para. 43 dhe f. 12-13.

⁷⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes para. 5-6.

shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

27. Neni 22 i Kushtetutës parasheh që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me, midis tjerash, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), dhe Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (KKT) garantohen në Kushtetutë dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

28. Në nenin 8 të DUDNJ-së përcaktohet se çdokush ka të drejtë për mjet ligjor efektiv nga tribunalët kompetentë shtetërorë për vepra që shkelin të drejtat themelore të miratuara me kushtetutë ose me ligj. Ngjashëm, KEDNJ-ja dhe KNDCP-ja parashohin të drejtën e qasjes në gjykatë dhe të drejtën për mjet ligjor efektiv (nenet 6(1) dhe 13(1) të KEDNJ-së dhe nenet 2(3)(a) dhe 14(1) të KNDCP-së). Konkretisht, në nenin 13(1) të KEDNJ-së dhe në nenin 2(3)(a) të KNDCP-së thuhet se çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë të përcaktuara në KEDNJ dhe MNDCP, përkatësisht, “gëzon mjet ligjor efektiv”. Gjithashtu, neni 14 i KKT-së parasheh që: “Çdo shtet palë, në sistemin e vet juridik garanton zhdëmtimin e viktimave të një akti torture dhe të drejtën e zbatueshme për t’u dëmshpërblyer me drejtësi dhe në mënyrë adekuate, duke përfshirë mjetet për riaftësim sa më të shpejtë. Në rast të vdekjes së viktimës si rezultat i veprave të torturës, personat në ngarkim të tij kanë të drejtë për dëmshpërblim”.

29. Në nenin 53 të Kushtetutës thuhet se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

30. Sa i përket të drejtës për mjet ligjor sipas nenit 13 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka konstatuar se obligimi i shteteve sipas nenit të lartpërmendur gjithashtu përfshin edhe obligimin për të garantuar që ky mjet ligjor të jetë i zbatueshëm, meqenëse miratimi i mjetit ligjor pa garantuar zbatimin e tij do të ishte i papajtueshëm me parimin e shtetit ligjor.⁷⁵

31. Parimet dhe Direktivat Themelore të Kombeve të Bashkuara për Mjete Juridike dhe Zhdëmtim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të të Drejtave Universale të Njeriut dhe të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare gjithashtu parashohin që, në rastet e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, e drejta e viktimave për mjet ligjor përfshin, sipas të drejtës ndërkombëtare, qasje të barabartë dhe efektive në drejtësi dhe zhdëmtim të mjaftueshëm, efektiv dhe pa vonesë për dëmin e pësuar; gjithashtu, shtetet duhet të përpiqen që të krijojnë programe shtetërore për zhdëmtim dhe ndihmë tjetër për viktimat në rast se palët përgjegjëse për dëmin e pësuar nuk janë në gjendje ose nuk duan t'i përmbushin obligimet e veta; për më tepër, shtetet duhet të ofrojnë mekanizma efektivë për zbatimin e aktvendimeve për zhdëmtim sipas ligjeve të tyre shtetërore.⁷⁶

⁷⁵ ECtHR *Kenedi v. Hungary*, nr. 31475/05, [Judgment](#), 26 August 2009, para. 47; *Kaić and Others v. Croatia*, no. 22014/04, [Judgment](#), 17 October 2008, para. 40; *Z and Others v. the United Kingdom*, nr. 29392/95, [Judgment](#), 10 May 2001, para. 110-111.

⁷⁶ UN General Assembly, [Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#), U.N. Doc. A/RES/60/147, 16 December 2005, para. 11(a)-(b), 16, 17.

IV. ANALIZË

A. ÇËSHITJE PARAPRAKE

32. Trupi Gjykses merr shënim se Mbrojtja dëshiron të marrë në pyetje ekspertët e caktuar.⁷⁷ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se ekspertët e caktuar janë udhëzuar nga Trupi Gjykses⁷⁸ dhe jo nga palët⁷⁹ apo nga mbrojtësja e viktimave. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se këto udhëzime u dhanë pas identifikimit nga ZPV-ja,⁸⁰ me urdhër të Trupit Gjykses,⁸¹ të ekspertëve të mundshëm për shqyrtim nga Trupi Gjykses dhe se Mbrojtja pati mundësi në dy raste të bënte parashtrime për listat e ekspertëve të propozuar të identifikuar nga ZPV-ja.⁸² Sidoqoftë, Mbrojtja nuk e shfrytëzoi këtë mundësi. Për më tepër, pas njoftimit të aktekspertizave, Mbrojtja bëri të ditur se nuk kishte parashtrime në lidhje me aktekspertizat⁸³ dhe nuk paraqiti argumente në mbështetje të kërkesës së saj për t'i marrë në pyetje ekspertët e caktuar.

33. Trupi Gjykses gjithashtu kujton se e konsideroi të nevojshme që t'i udhëzonte ekspertët e caktuar që të qartësonin nëse gjykatat e Kosovës ofrojnë mundësi reale për viktimat e krimeve në çështjen aktuale që të kërkojnë zhdëmtim dhe, nëse kompensimet do të miratoheshin me aktvendime të lëshuara nga gjykatat e Kosovës, që ato aktvendime të zbatoheshin.⁸⁴ Rrjedhimisht, qëllimi i vetëm i aktekspertizave është që ta ndihmojnë Trupin Gjykses në marrjen e vendimit nëse, në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, a duhet t'i referojë viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës në pajtim me nenin 22(9) të Ligjit dhe rregullën 167 të

⁷⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes para. 6.

⁷⁸ *Shih* Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve.

⁷⁹ *Krahaso* rregulla 149 e Rregullores, që ka të bëjë me provat e dëshmitarëve ekspertë të thirrur nga palët.

⁸⁰ Parashtrimi i Parë i ZPV-së dhe Shtojcat 1-3 të tij; Parashtrimi i Dytë i ZPV-së dhe Shtojcat 1-4 të tij.

⁸¹ Vendimi, para. 24(a); Vendim i Dytë, para. 9-10, 12(a).

⁸² Vendimi, para. 24(b); Vendimi i Dytë, para. 12(b).

⁸³ Parashtrimet e Mbrojtjes para. 5.

⁸⁴ Vendimi, para. 20.

Rregullores, apo të lëshojë Urdhër për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit. Për këtë arsye, ndikimi – nëse ka – i aktekspertizave, dhe rrjedhimisht i vendimit aktual, është minimal mbi të drejtat e të akuzuarve, meqenëse pyetja që shtrohet ka të bëjë me përcaktimin se cili forum gjyqësor do të vendosë përfundimisht për kërkesat për zhdëmtim në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, e jo për përgjegjësinë civile të të akuzuarve, nëse do të ketë. Pyetja e fundit është e parakohshme në këtë fazë.

34. Në këto rrethana, duke pasur parasysh në veçanti se: (i) Mbrojtja nuk e shfrytëzoi mundësinë që të parashtronte vërejtje lidhur me listën e ekspertëve të propozuar nga ZPV-ja; (ii) Mbrojtja shprehimisht bëri të ditur se nuk ka parashtrime në lidhje me aktekspertizat dhe nuk paraqiti argumente në mbështetje të kërkesës së vet për t'i marrë në pyetje ekspertët e caktuar; dhe duke pasur parasysh (iii) lëndën e aktekspertizave, Trupi Gjykes nuk e konsideron të nevojshme të thërrasë ekspertët e caktuar për marrje në pyetje nga Mbrojtja. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes e hedh poshtë Kërkesën e Mbrojtjes.

B. NË RAST SE DO TË KETË SHPALLJE TË FAJËSISË, A DO T'I REFERONTE TRUPI GJYKUES VIKTIMAT PËR PADI CIVILE NË GJYKATAT E KOSOVËS NË PAJTIM ME NENIN 22(9) TË LIGJIT APO DO TË LËSHONTE URDHËR PËR ZHDËMTIM NË PËRPUTHJE ME NENET 22(8) DHE 44(6) TË LIGJIT

35. Sa i përket të drejtës për mjete ligjore efektive dhe zbatimin e tyre në gjykatat e Kosovës, Trupi Gjykes së pari vëren se të gjithë ekspertët e caktuar vënë në dukje disa mangësi në sistemin gjyqësor të Kosovës që mund të ndikojnë te viktimat e krimeve që kërkojnë zhdëmtim në çështjen aktuale, nëse, në rast të shpalljes së fajësisë, Trupi Gjykes do t'i referojë viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës. Sipas ekspertëve të caktuar, këto mangësi përfshijnë: (i) ekzistencën e mundshme të një shkalle korrupsioni dhe ndërhyrjeje brenda

sistemit juridik në Kosovë dhe mungesën e strukturave efikase të llogaridhënies për gjyqësorin;⁸⁵ (ii) kohëzgjatjen e proceseve civile;⁸⁶ (iii) problemet e mundshme në lidhje me zbatimin e dëmshpërblimeve të shpallura nga gjykatat e Kosovës ndaj pasurive që gjenden në territorin e një vendi që nuk ka marrëveshje për bashkëpunim gjyqësor apo lidhje diplomatike me Kosovën;⁸⁷ (iv) faktin që fondet ekzistuese për dhënie e ndihmës juridike mund të mos kenë mjete të mjaftueshme që të garantojnë ndihmën e vazhdueshme juridike;⁸⁸ dhe (v) paqartësinë sa i përket zbatimit të afateve të parashkrimit, nëse ekzistojnë, për padi civile të ngritura nga viktimat e krimeve të luftës.⁸⁹

36. Trupi Gjyqësor nuk shpreh mendim në lidhje me mangësitë e mundshme të lartpërmendura, meqenëse mendon se faktori në vijim është kyç për vendimin e vet.

37. Trupi Gjyqësor thekson se, duke u bazuar në informacionin e dhënë nga ekspertët e caktuar, duket se korniza ligjore aktuale në Kosovë nuk parasheh padi civile anonime dhe/ose mundësi për masa mbrojtëse në çështje civile në përgjithësi.⁹⁰ Megjithatë eksperti i tretë parashtron se dispozitat ligjore përkatëse sugjerojnë se personi që ngre padi private mund të kërkojë zbatimin e masave të caktuara mbrojtëse kur paraqet arsye të vlefshme, sipas të njëjtit ekspert, bazuar në praktikën gjyqësore deri më sot dhe në hulumtimin e kryer për aktekspertizën e tretë, kjo nuk ka ndodhur asnjëherë në praktikë.⁹¹ Për më tepër, sa i përket përvojës praktike të gjykatave të Kosovës në lidhje me paditë për zhdëmtim në

⁸⁵ *Shih* Aktekspertiza e Parë, f. 3-12; Aktekspertiza e Dytë, para. 18-30; Aktekspertiza e Tretë, f. 24, 30, 36.

⁸⁶ *Shih* Aktekspertiza e Parë, f. 9, 13-14, 31-34; Aktekspertiza e Dytë, para. 48-49; Aktekspertiza e Tretë, f. 21, 24, 30-33, 41-42, 52-53.

⁸⁷ Aktekspertiza e Parë, f. 36-39; Aktekspertiza e Tretë, f. 57.

⁸⁸ Aktekspertiza e Tretë, f. 23-25.

⁸⁹ Aktekspertiza e Parë, f. 30-31; Aktekspertiza e Dytë, para. 46.

⁹⁰ *Shih* Aktekspertiza e Parë, f. 21-24; Aktekspertiza e Dytë, para. 39-40, 42-43; Aktekspertiza e Tretë, f. 13, 21, 25, 29, 47-48.

⁹¹ Aktekspertiza e Tretë, f. 47.

çështjet e krimeve të luftës,⁹² Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se, sipas ekspertit të tretë, nuk ka pasur asnjë çështje të konfirmuar në Kosovë ku viktima ka iniciuar procedura për kompensim pas nxjerrjes së aktgjykimit përfundimtar në një çështje të krimeve të luftës.⁹³ Sipas këtij eksperti, kjo mund të jetë për shkak, midis të tjerash, të faktit se viktima të tilla, pasi kanë shfrytëzuar anonimitetin apo masa të tjera mbrojtëse në procese penale, ndoshta nuk duan që të kërkojnë kompensim në mënyrë publike nga anëtarët e dënuar të UÇK-së, gjithashtu duke pasur parasysh mospajtimin e gjerë të publikut me gjykime të tilla.⁹⁴

38. Informacioni i mësipërm është në kundërshtim të thellë me mundësitë e disponueshme dhe masat e zbatuara në Dhomat e Specializuara. Trupi Gjykses kujton se për viktimat në çështjen aktuale janë miratuar masat mbrojtëse më të gjera të disponueshme brenda kornizës ligjore të DHS-së, përfshirë spektrin e plotë të masave mbrojtëse në sallën e gjyqit, për të mbrojtur identitetin e tyre nga publiku gjatë dhënies së dëshmive të tyre.⁹⁵ Këto masa mbrojtëse u miratuan pas konstatimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake se [REDAKTUAR].⁹⁶ Për më tepër, edhe pse nuk përmendet shprehimisht në nenin 22(3) të Ligjit, mbrojtja e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së viktimave që parashihet në nenin 23 të Ligjit duhet të kuptohet si pjesë thelbësore e interesave dhe të drejtave personale të viktimave.⁹⁷ Për pasojë, Trupi Gjykses duhet të garantojë mbrojtjen e viktimave siç parashihet në nenin 23 të Ligjit gjatë të gjithë procesit gjyqësor, përfshirë procedurat për zhdëmtim, pavarësisht nga

⁹² *Shih* Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve, para. 13.

⁹³ Aktekspertiza e Tretë, f. 19.

⁹⁴ Aktekspertiza e Tretë, f. 19-20.

⁹⁵ Masat e miratuara mbrojtëse në sallën e gjyqit janë: caktimi i pseudonimeve dhe identifikimi përmes tyre gjatë gjithë procesit; redaktimi i emrave dhe të dhënave identifikuese nga dokumentet publike të DHS-së; mosnxjerrja për publikun e të dhënave identifikuese; dhënia e dëshmisë me ndryshimin e pamjes dhe zërit; dhe seanca të mbyllura ose private për çfarëdo diskutimi apo dëshmie identifikuese në sallën e gjyqit. *Shih* [REDAKTUAR].

⁹⁶ [REDAKTUAR].

⁹⁷ Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 11.

forumi ku kryhen procedurat për zhdëmtim. Veçanërisht, obligimi për mbrojtjen e viktimave dhe të familjeve të tyre vazhdon edhe pas përfundimit të gjykimit para Trupit Gjykses.⁹⁸ Për këto arsye, aftësia për të mbrojtur identitetin e viktimave dhe, për pasojë, sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike të tyre dhe të familjeve të tyre, përbën faktor kyç që Trupi Gjykses mban parasysht gjatë vlerësimit nëse viktimat duhet të referohen për padi civile në gjykatat e Kosovës në rast se do të ketë shpallje të fajësisë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses gjithashtu i kushton vëmendje vlerësimit të ekspertit të dytë se “nëse viktimat nuk kanë vullnet dhe gatishmëri të vazhdojnë me padi civile në Kosovë me identitetin e tyre të zbuluar, çdo diskutim tjetër në lidhje me sistemin gjyqësor në Kosovë mund të jetë i padobishëm në aspektin praktik”.⁹⁹

39. Bazuar në informacionin që ka, dhe duke marrë parasysht të gjitha faktet dhe rrethanat, Trupi Gjykses konstaton se referimi i viktimave te gjykatat e Kosovës bart rrezikun e cenimit të masave të marra nga DHS-ja për mbrojtjen e viktimave në procesin gjyqësor aktual, sepse do të pamundësonte mbrojtjen e mjaftueshme të identitetit të tyre. Rrjedhimisht, përfundimi i vetëm i mundshëm i Trupit Gjykses është se gjykatat shtetërore në Kosovë nuk ofrojnë mundësi reale për viktimat që të kërkojnë zhdëmtim.

40. Për sa më sipër, Trupi Gjykses konsideron se nuk do të ishte e përshtatshme që viktimat të referohen për padi civile në gjykatat e Kosovës në pajtim me nenin 22(9) të Ligjit dhe rregullën 167 të Rregullores. Në vend të kësaj, në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, Trupi Gjykses do të lëshojë Urdhër për Zhdëmtim në përputhje me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

⁹⁸ *Shih* rregulla 81(1) e Rregullores.

⁹⁹ Aktekspertiza e Dytë, f. 23.

C. HAPAT E MËTEJSHËM PROCEDURALË

41. Pasi ka arritur në përfundimin se në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, Trupi Gjykes nuk do t'i referojë viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës, por do të lëshojë Urdhër për Zhdëmtim, Trupi Gjykes kujton se procedurat për zhdëmtim janë brenda fushëveprimit të nenit 6(1) të KEDNJ-së dhe se viktimat gëzojnë të drejtat procedurale sipas nenit të lartpërmendur lidhur me kërkesat e tyre për zhdëmtim.¹⁰⁰ Këtu përfshihen ndër të tjera, e drejta e paraqitjes së çfarëdo prove që viktimat do ta konsideronin të rëndësishme në mbështetje të kërkesave të tyre për zhdëmtim,¹⁰¹ pa kërkuar leje nga Trupi Gjykes për paraqitjen e provave të tilla dhe pas pasur nevojë të kërkojnë nga Trupi Gjykes që të urdhërojë paraqitjen e tyre.¹⁰² Në këto rrethana, Trupi Gjykes e konsideron të arsyeshme që të caktojë kalendarin për hapat e ardhshëm proceduralë për paraqitjen e provave në lidhje me zhdëmtimet.

42. Trupi Gjykes u referohet Parashtrimeve të 24 janarit të Viktimave, ku mbrojtësja e viktimave kërkon, ndër të tjera, që Trupi Gjykes të caktojë një ekspert për të bërë një vlerësim mjekësor të dëmit fizik dhe psikologjik të pësuar nga tri prej viktimave të drejtpërdrejta në këtë çështje, në kuadër të përcaktimit të zhdëmtimit dhe zbardhjes së të vërtetës.¹⁰³ Ndërsa kërkesa e lartpërmendur e mbrojtëses së viktimave do të trajtohet nga Trupi Gjykes në kohën e duhur, Trupi Gjykes e konsideron të përshtatshme që t'i japë mbrojtëses së viktimave mundësinë të plotësojë, deri të premtën, 11 shkurt 2022, Parashtrimet e 24 janarit të Viktimave me dëshmitarë (ekspertë) të tjerë të propozuar dhe me çfarëdo material i jогоjor që dëshiron të paraqesë, nëse ka, në lidhje me zhdëmtimet,

¹⁰⁰ Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 12.

¹⁰¹ Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 12.

¹⁰² Kjo nuk e cenon të drejtën e mbrojtëses së viktimave që të kërkojë nga Trupi Gjykes, në pajtim me nenet 39(13) dhe 40(6)(a) të Ligjit, lëshimin e çfarëdo urdhri që mund ta ndihmojë në përgatitjen e paraqitjes së saj të provave (Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 38).

¹⁰³ Parashtrimet e 24 janarit të Viktimave, para. 4, 12-29, 31(a).

përfshirë, sipas rastit, informacionin e përcaktuar në paragrafët 34-35 të Vendimit mbi të Drejtat e Viktimave. Mbrojtja mund t'ua përgjigjet parashtrimeve të tilla, nëse dëshiron, deri të mërkurën, 16 shkurt 2022, në mesditë.

43. Për më tepër, për të garantuar procedim të drejtë dhe të shpejtë, Trupi Gjykses mund të mbajë konferencë mbi ecurinë e çështjes, për të diskutuar dhe organizuar paraqitjen e provave në lidhje me zhdëmtimet.¹⁰⁴ Kjo konferencë mbi ecurinë e çështjes do të mbahet së bashku me konferencën për përgatitjen e Mbrojtjes dhe konferencën mbi ecurinë e çështjes për paraqitjen e provave në lidhje me zbardhjen e të vërtetës të thirrur nga Trupi Gjykses me kërkesë të mbrojtëses së viktimave të enjten, 17 shkurt 2022, duke filluar në orën 09:30, me të premtën, 18 shkurt 2022 si ditë rezervë, duke filluar në orën 09:30. Pas kësaj, Trupi Gjykses mund të përcaktojë kohëzgjatjen dhe kuadrin e paraqitjes së provave lidhur me zhdëmtimet, nëse do të ketë, përfshirë datën e fillimit për dëgjimin e provave të tilla.

44. Në mënyrë që të ndihmohet Trupi Gjykses dhe të shpejtohen parashtrimet që do të bëhen në gjykatë, mbrojtësja e viktimave do të dorëzojë deri të mërkurën, 16 shkurt 2022 në mesditë, parashtrime me shkrim për pikat e renditura në pjesën III.D të Vendimit të Dytë për Zhvillimin e Gjykimit që ka të bëjë me paraqitjen e provave lidhur me zhdëmtimet.

D. PYETJET PËR MINISTRINË E DREJTËSISË SË KOSOVËS

45. Trupi Gjykses kujton se disa nga pyetjet e shtruara për ekspertët e caktuar kishin të bënin me opsionet e mundshme për viktimat lidhur me marrjen e kompensimit në rast se Trupi Gjykses do të vendoste që mos t'i referonte për padi civile te gjykatat e Kosovës, dhe në rast se të akuzuarit do të shpallehin fajtorë e nuk do të ishin në gjendje të paguanin dëmshpërblimet që mund të urdhëroheshin

¹⁰⁴ Vendimi mbi të Drejtat e Viktimave, para. 33.

nga Trupi Gjykses.¹⁰⁵ Në lidhje me këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se, sipas informacionit të dhënë nga ekspertët e caktuar: (i) viktimat e krimeve brenda juridiksionit të DHS-së mund të përfitonin dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur në paragrafin 15 të Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve ose nga programet e tjera për kompensim,¹⁰⁶ edhe pse nuk ka informacion që tregon se viktimat e krimeve të luftës kanë përfituar ndonjëherë kompensim nga fondi i lartpërmendura;¹⁰⁷ dhe (ii) Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit nuk vlen për viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së,¹⁰⁸ ndërsa neni 6(2) i tij mund t'i japë komisionit njëfarë fleksibiliteti në lidhje me pretendimet e viktimave që kanë të bëjnë me vepra të tjera të rënda penale.¹⁰⁹

46. Duke pasur parasysh nevojën për të garantuar të drejtën efektive të viktimave për zhdëmtim në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit dhe të instrumenteve ligjore ndërkombëtare përkatëse të përmendura në pjesën III të këtij vendimi, nëse të akuzuarit, në rast se shpallen fajtorë, nuk janë në gjendje të paguajnë dëmshpërblime që mund të urdhërohen nga Trupi Gjykses, Trupi Gjykses konsideron se është e domosdoshme që të marrë informacion shtesë në lidhje me mundësitë e disponueshme për viktimat. Për më tepër, duke pasur parasysh obligimin e Trupit Gjykses që të garantojë mbrojtjen e viktimave siç parashihet në nenin 23 të Ligjit gjatë tërë procesit gjyqësor, përfshirë procedurat për zhdëmtim,¹¹⁰ Trupi Gjykses konsideron se është e nevojshme që të marrë

¹⁰⁵ Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve, para. 15.

¹⁰⁶ Aktekspertiza e Tretë, f. 28, 50.

¹⁰⁷ Aktekspertiza e Tretë, f. 19, 23, 50.

¹⁰⁸ *Shih* Aktekspertiza e Parë, f. 15-16, 19, 46; Aktekspertiza e Dytë, para. 47, 67; Aktekspertiza e Tretë, f. 14, 29, 50.

¹⁰⁹ *Shih* Aktekspertiza e Tretë, f. 14-15, 29, 50.

¹¹⁰ *Shih më lart* para. 38.

informacion shtesë për shqyrtimin e mundësive që viktimat të përfitojnë kompensim duke ruajtur anonimitetin, nëse mundësi të tilla ekzistojnë.¹¹¹

47. Në këto rrethana, dhe duke pasur parasysh se Ministria e Drejtësisë e Kosovës është institucioni më i përshtatshëm për dhënien e informacionit të kërkuar,¹¹² Trupi Gjykses konsideron se është e përshtatshme t'i kërkojë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës që, deri të mërkurën, 16 mars 2022, t'i paraqesë Trupit Gjykses përgjigje për pyetjet në vijim:

- Në rast se të akuzuarit do të shpallehin fajtorë dhe Trupi Gjykses do të lëshonte Urdhër për Zhdëmtim, në qoftë se të akuzuarit nuk do të jenë në gjendje të paguajnë zhdëmtimet që do të urdhërojë Trupi Gjykses, a do të mund të përfitonin viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur në nenin 19(1), pjesa 1.26, dhe 62(1), pjesa 1.5, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, apo nga cilido program përkatës për kompensim, përfshirë atë të krijuar sipas Ligjit Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit;
- A do të përfitonin viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur më lart apo nga cilido program përkatës për kompensim duke ruajtur anonimitetin pas nxjerrjes së Urdhrit për Zhdëmtim nga Trupi Gjykses;
- Për të ruajtur anonimitetin e viktimave, a do të mund Administratorja, me ndihmën e Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës, sipas nevojës, të bënte

¹¹¹ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se pyetjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e anonimitetit të viktimave të përmendura në paragrafin 15 të Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve nuk u trajtuan nga eksperti i parë dhe eksperti i dytë, ndërsa sipas ekspertit të tretë, edhe nëse DHS-ja do t'i gjykonte kërkesat për kompensim, ka shumë të ngjarë që zbatimi i vendimeve të tilla në Kosovë nuk do të mundësonte ruajtjen e anonimitetit të viktimave (Aktekspertiza e Tretë, f. 29).

¹¹² *Shih* Aktekspertiza e Parë, f. 17 dhe poshtëshënimi 28; Aktekspertiza e Tretë, f. 14, 16, 19, 23, 48. *Shih gjithashtu*, ndonëse në lidhje me informacionin që ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar, Aktekspertiza e Dytë, para. 37. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se [REDAKTUAR].

kërkesë për dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur më lart apo nga cilido program përkatës për kompensim të përmendur më lart në emër të viktimave, pas nxjerrjes së Urdhrit për Zhdëmtim nga Trupi Gjykses; dhe

- Në rast se viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së nuk do të mund të përfitonin dëmshpërblim nga cilido program ekzistues për kompensim, a do të mund të krijohej një fond për këtë qëllim, i financuar nga buxheti i Kosovës ose nga burime të tjera, ku Administratorja do të mund të bënte kërkesë për dëmshpërblim në emër të viktimave, me qëllim që të ruhet anonimiteti i tyre. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konkretisht thekson se financimi i mbrojtjes së të akuzuarve para DHS-së nga buxheti i Kosovës është bërë i mundshëm me anë të Ligjit Nr. 05-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara.

48. Ministria e Drejtësisë e Kosovës kujtohet se, në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë bashkëpunojnë dhe përmbushin pa vonesë të paarsyeshme çdo kërkesë për ndihmë ose urdhër të lëshuar nga DHS-ja.

49. Në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores, dërgimi i versionit të redaktuar publik të vendimit aktual të Ministria e Drejtësisë e Kosovës bëhet përmes Administratores.

V. VENDIM

50. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **HEDH POSHTË** Kërkesën e Mbrojtjes;
- b. **VENDOS** që, në rast se do të ketë shpallje fajësie, nuk do t'i referojë viktimat për padi civile në gjykatat e Kosovës sipas nenit 22(9) të Ligjit dhe rregullës 167 të Rregullores, por do të nxjerrë Urdhër për Zhdëmtim në pajtim me nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit;
- c. **URDHËRON** mbrojtësen e viktimave që, deri të **premtën, 11 shkurt 2022**, të plotësojë në qoftë se dëshiron, Parashtrimet e 24 janarit të Viktimave me dëshmitarë (ekspertë) të propozuar të tjerë dhe me material të rëndësishëm jogojor në lidhje me kompensimet që dëshiron t'i paraqesë, nëse ka, përfshirë, sipas rastit, informacionin e përcaktuar në paragrafët 34-35 të Vendimit mbi të Drejtat e Viktimave dhe që Mbrojtja të përgjigjet ndaj parashtrimeve të tilla deri të **mërkurën, 16 shkurt 2022, në mesditë**, nëse dëshiron;
- d. **KËRKON** nga mbrojtësja e viktimave që të protokollojë, deri të **mërkurën, 16 shkurt 2022, në mesditë**, parashtrime me shkrim siç është saktësuar në paragrafin 44 më lart;
- e. **URDHËRON** Administratoren që t'ia dërgojë vendimin aktual, në formë të redaktuar publike, Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës; dhe
- f. **URDHËRON** Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës që t'i paraqesë Trupit Gjykses, deri të **mërkurën, 16 mars 2022**, përgjigjet lidhur me pyetjet e përmendura në paragrafin 47 të vendimit aktual.

/nëshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 4 shkurt 2022

Në Hagë, Holandë.